



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo	
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST INFORMATION AND PRIVACY AGENCY	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - АРХИВНО БЮРО	
Njesia Org. Org. Jed. Org. Unit	Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No.
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. of Pages	Data: Datum: Date:
04	335
06	21.03.2025

Nr. 45/2025
Datë: 21.03.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 64, paragrafi 1, nënparagrafi, 1.5, nenin 68, paragrafi, 1, nenin 69, nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.6, nenin 91 paragrafi 1.2, 1.5 dhe 1.9, nenin 94, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 13, (paragrafi 3, nënparagrafi 3.1) të Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me nr. protokolli 300, të parashtruar nga subjekti i të dhënave, ndaj kontrolluesit “Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina” Sh.A, Prishtinë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohen** si të bazuara ankesa me numër të protokollit 300, e parashtruara nga subjekti i të dhënave ndaj kontrolluesit “Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina” Sh.A.
2. Shqiptohet gjobë në vlerë prej **25,000.00 € (njëzet e pesëmijë euro)**, ndaj “Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina” Sh.A ,në cilësinë e kontrolluesit, me NUI: 810547549, me adresë, Rr. Hazir Shala Nr. 4, Prishtinë, për shkeljen e dispozitave për sigurinë e të dhënave personale.
3. **Urdhërohet** kontrolluesi, të ndërmarr masat e nevojshme për sigurinë e të dhënave personale (në faturat), siç parashihet në nenin 31 të Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Obligohet kontrolluesi, që shumën e përcaktuar nga pika 2 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 30 ditësh, në xhironlogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 1000400070005127 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.

6. Obligohet kontrolluesi, që brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojë Agjencinë me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 20.03.2025, përmes postës elektronike (e-mail) ka pranuar ankesë e cilat mbanë numrin e protokollit 300, e parashtruar nga subjekti i të dhënave, në lidhje me atë se, nga “Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Prishtina” Sh.A, kanë pranuar dhe vazhdon të pranoj faturat e shpenzimit të ujit në mënyrë të hapur pa zarfe, të vendosur në kutia postare gjysmë jashtë edhe pas vendimit të AIP-së, duke i bërë të qasshme edhe për palët e treta. Në ankesën e pranuar nga pala ankuese, janë bashkangjitur edhe provat (fotografitë e faturave të vendosura sipas pretendimeve të ankuesve).

Bazuar në nenit 68, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia ka filluar procedurën e shqyrtimit të ankesës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Gjatë shqyrtimit të provave të pranuar nga ankuesit, nga fotografitë e dërguara shihen qartë se shpërndarja e faturave për shpenzimin e ujit, në të cilën gjenden të dhënat personale të subjekteve të të dhënave (emri, mbiemri, adresa, shpenzimi i ujit), është bërë duke i vendosur në kuti postare në të cilat gjysma e faturave është jashtë kutisë postare ku mund të kenë qasje çdo kush, kështu duke i bërë të qasshme për personat e tjerë.

Lidhur me ndërmarrjen e masave për të siguruar të dhënat personale të subjekteve të të dhënave (konsumatorëve) gjatë shpërndarjes së faturave, Agjencia për Informim dhe Privatësi, më datë 29.02.2024, përmes postës elektronike iu është drejtuar me shkresë Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit Prishtina, përmes së cilës iu janë sqaruar obligimet ligjore për ndërmarrjen e masave të duhura të sigurisë, me rastin e shpërndarjes së faturave tek konsumatorët e saj dhe të njëjtin ta realizoj në formatin që garanton mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Në shkresën e lartcekur, me qëllim të përgatitjes, Agjencia, i ka dhënë afat kohor që deri më datë 30.06.2024, pra afat prej katër (4) muajsh, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të konsumatorëve të saj. Me qëllim të rikujtimit të obligimeve, Agjencia, përsëri më datë 18.06.2024, përmes postës elektronike ka ri-dërguar kërkesën e datës 28.02.2024.

Me këtë rast, pas pranimit të ankesave dhe shqyrtimit të provave të pranuar nga ankuesit, Agjencia, më datë 07.08.2024, përmes postes elektronike, ka njoftuar kontrolluesin me ankesat e pranuar dhe njëheri ka kërkuar që të na njoftoj lidhur me pretendimet e palëve ankuese.

Më datë 12.08.2024, Agjencia, përmes postes elektronike ka pranuar një shkresë nga kontrolluesi, me të cilën ka njoftuar se: “Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A ju njofton se nga muaji Korrik 2024 ka filluar zbatimin dhe aplikimin e formës së shpërndarjes së faturave me pliko të mbyllura gjithmonë duke e zbatuar Ligjin NR.06/l-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A prej fillimit të zbatimit dhe aplikimit të kësaj çështje, ka shtuar kujdes të veçantë dhe përkushtim në prona publike dhe vendbanime kolektive për

shpërndarjen e faturave me pliko të mbyllura, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe lirit themelore të personave fizik dhe juridik, për të garantuar sistem të lartë sigurie dhe konfidencialitetin e plotë për të ruajtur të dhënat personale të tyre.”.

Analiza Ligjore dhe të Gjeturat

Sipas regjistrimit të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), “Kompania Rajonale e Ujësjetës Prishtina Sh.A., është shoqëri aksionare që vepron dhe është e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, e regjistruar në tetor të vitit 2007, me Numër Unik Identifikues - NUI: 810547549, me adresë në Rr. “Tahir Zajmi”, Prishtinë. Veprimtaria kryesore e regjistruar është grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë (kodi 3600).

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’ me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, “Kompania Rajonale e Ujësjetës Prishtina” Sh.A, cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të LMDhP-së, me të dhëna personale nënkuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Në kuptimin e kësaj dispozite, edhe fatura e shpenzimit të ujit, përmban të dhëna personale, përfshirë emrin, mbiemrin, adresën si dhe konsumi mujor, i cili indirekt mundëson zbulimin e të dhënave financiare të familjes (borxhet), pra të dhëna personale të cilat mund të keqpërdoren dhe mund të kenë pasoja për subjektin e të dhënave.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, ligji, në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptohet çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Bazuar në LMDhP, përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë i ligjshëm.

LMDhP në nenin 4, parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Njëri ndër këta parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Pra, si parim shumë i rëndësishëm është ligjshmëria e përpunimit. por kjo nuk nënkupton se parimet tjera kanë më pak rëndësi por vetëm se me rastin e përpunimit të të dhënave personale si fillim duhet të shikuar ligjshmëria e përpunimit pastaj pasojnë parimet tjera me radhë siç janë: parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i kufizimit të ruajtjes së të dhënave, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund, parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lart.

Sipas nenit 5, paragrafi 1, të LMDhP-së, përpunimi i të dhënave personale, përpunimi është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbushjen e detyrave të tyre.

Në këndvështrimin e kësaj dispozite, bazën ligjore për përpunimin e të dhënave personale të konsumatorëve, kontrolluesi e mbështetë në nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LMDhP-së, pasi që përpunimi i të dhënave të konsumatorëve është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjektet e të dhënave (konsumatorët) janë palë kontraktuese. Mirëpo, kontrolluesi edhe pse ka bazën ligjore për përpunimin e të dhënave personale të konsumatorëve, e cila përmbushë parimin e ligjshmërisë, në këtë rast ekzistimi i një bazë ligjore për përpunimin e të dhënave personale, nuk nënkupton që kontrolluesi nuk duhet t'i përmbahet edhe dispozitave të tjera të përcaktuara me LMDhP.

Me rastin e përpunimit të të dhënave personale, përveç parimit të parimi i ligjshmërisë, kontrolluesi duhet të respektoj të gjitha parimet e përcaktuara në nenin 4, të LMDhP-së. Në rastin konkret kontrolluesi obligohet të respektoj parimin e paprekshmërisë dhe konfidencialitetit, i cili është i përcaktuar në nenit 4, paragrafin 6, të LMDhP-së, sipas të cilit të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.

Bazuar në nenin 31, paragrafi 1 të LMDhP-së, kontrolluesi dhe përpunuesi, duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, shpenzimet e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit si dhe rrezikun e mundësisë së ndryshimit, si dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit: 1.1. pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; 1.2. aftësinë për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit; 1.3. aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat personale në kohën e duhur, në rastin e një incidenti fizik ose teknik; 1.4. Një proces të testimit, vlerësimit të rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton se në vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të sigurisë duhet të merren parasysh, veçanërisht, rreziqet që paraqiten nga përpunimi, si nga asgjësimi, humbja, ndryshimi aksidental ose i paligjshëm, deklarimi i paautorizuar ose qasja në të dhënat personale të transmetuara, ruajtura ose përpunuara ndryshe.

Në këndvështrimin e këtyre depozitave, kontrolluesi me rastin e shpërndarjes së faturave tek konsumatorët, nuk ka ndërmarr masat duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm të përpunimit të të dhënave personale, pasi që mënyra e shpërndarjes që është bërë dhe ka vazhduar të bëhet edhe pas afatit të dhënë dhe Vendimit të marrë me Nr.186/2024, të marrë më datë 16.08.2024 nga Agjencia, i lejon në mënyrë shumë të lehtë qasje personave të tjerë në të dhënat personale të subjekteve të të dhënave.

Andaj, nga e gjithë kjo që u tha më lartë, bazuar në ankesën e subjektit të të dhënave, faktet e paraqitura, Agjencia konstaton se kontrolluesi me rastin e shpërndarjes së faturave me të dhëna personale tek konsumatorët e saj, nuk ka marrë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rreziqeve të përfshira në përpunimin e të dhënave personale nga ai dhe me këtë rast ka përpunuar (shpërndarë) të dhëna personale në kundërshtim me nenin 4, paragrafin 6 dhe nenin 31 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për këtë arsye, kontrolluesit i shqiptohet gjobë kundërvajtëse siç është e përcaktuar në nenin 94, paragrafi 1 të LMDhP-së.

Vlen të theksohet se kontrolluesi, edhe pas Vendimit me Nr. 186/2024, të marrë nga Agjencia për shqiptimin e gjobës dhe urdhër për ndërmarrjen e masave të nevojshme për sigurinë e të dhënave personale (në faturat), kontrolluesi ka vazhduar, të dërgoj faturat e shpenzimit të ujit në mënyrë të njëjtë, duke i'u mundësuar qasje personave të tjerë.

Agjencia, për caktimin e vlerës së gjobës kundërvajtëse, ka marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 91, paragrafin 1 të LMDhP-së, me theks të veçantë natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e paralajmëruar se një veprim i tillë është i kundërligjshëm. Përveç kësaj ka marrë parasysh edhe Vendimi me Nr.186/2024, për shqiptimin e gjobës kundërvajtëse, për të njëjtën çështje.

Agjencia konsideron se gjoba kundërvajtëse e vendosur është efektive, që do të thotë se do të arrijë qëllimin për të ndëshkuar kontrolluesin për një shkelje të tillë, dhe si e tillë është proporcionale me shkeljen dhe është bindëse me qëllim që kontrolluesi në të ardhmen t'i shmanget sanksioneve të

tilla, e rrjedhimisht të përpunojë të dhëna personale në pajtim me ligjin. Objektivi bazë i LMDhP-së është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, pas shqyrtimit të ankesave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- “Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina” Sh.A – kontrollues,
- Palës ankuese,
- Arkivit të Agjencisë.